



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 17 paragrafi 3 të Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës Nr.03/L-212, Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të kërkesës për transferim të nëpunësit të shërbimit Publik Nazim Rustemi 02 Nr.016-01-120032 të datës 11.10.2022 merr këtë:

V E N D I M

1. Nëpunësi i shërbimit publik, Nazim Rustemi nga Fsh. Përlepnice, i sistemuar në pozitën punuese Roje Pylli në Sektorin e pyjeve në kuadër të Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari, Transferohet-Sistemohet në vendin e punës; Punëtor teknik në kuadër të SHFMU "Skënderbeu" në Fsh. Përlepnice nga data **01.12.2022**.

2. Nëpunësi i sistemuar nga pika 1 e këtij vendimi, realizimin e pagës do ta bëjë në institucionin edukativo arsimor-shkollë sipas pozitës në të cilën është transferuar-sistemuar

3. Me ndryshimin e pozitës dhe njësisë organizative brenda Institucionit, ndryshon edhe Kontrata e punës.

A R S Y E T I M

Nëpunësi i shërbimit publik, Nazim Rustemi i është drejtuar Kryetarit të Komunës në cilësinë e Organit më të lartë administrativ me kërkesën 02 Nr.016-01-120032 të datës 11.10.2022 me të cilën kërkon Transferimin-Sistemimin nga pozita punuese Roje Pylli në ndonjë pozitë ekuivalente punuese, sepse siç thekson i njëjti është i sëmur dhe ka pas ndërhyrje kirurgjikale për shkak të një ataku në zemër e që dëshmohet me dokumentacionin e bashkangjitur në kërkesë. I njëjti është i pajtimit që koeficienti i pagës ti caktohet sipas pozitës në të cilën transferohet-sistemohet.

Kryetari i komunës pas shqyrtimit të kërkesës në fjalë dhe duke pas parasysh gjendjen shëndetësore të nëpunësit dhe afërsinë me objektin shkollor pasi që i njëjti është i Fsh. Përlepnice dhe ekzistimin e pozitës së lirë punuese në shkollën e mësipërm cekur, në pajtim me nenin 17 paragrafi 3 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshilla Juridike : Kundër këtij vendimi nëpunësi i shërbimit publik ka të drejtë ankese në Komisionin komunal për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.

VENDIMI T'I DORËZOHET : Nëpunësit
Drejtorit të DKA
Arkivi

